

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA ILIA KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 22824/20)

VENDIM
STRASBURG
15 korrik 2025

Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Ilia kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *President,*

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelar i Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 22824/20) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) më 7 maj 2020 nga shtetasi shqiptar z. Bledar Ilia (“kërkuesi”), i lindur në vitin 1979, me banim në Tiranë dhe i përfaqësuar nga z. A. Kasapi, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) të përfaqësuar nga agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, për ankimin në lidhje me mungesën e aksesit të kërkuesit në Gjykatën Kushtetuese dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 24 qershor 2025,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë me një mosmarrëveshje punësimi ku kërkuesi kundërshtoi ndërprerjen e kontratës së tij me Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Kërkuesi u ankua për mungesën e aksesit të tij në Gjykatën Kushtetuese.

2. Pas rrëzimit të kërkesës së kërkuesit në shkallë të parë dhe të dytë, ai depozitoi ankimin në Gjykatën e Lartë në korrik 2014.

3. Më 8 nëntor 2016, në Fletoren Zyrtare u publikua ligji nr. 99/2016 i 6 nëntorit 2016. Ligji shkurtoi afatin kohor për depozitimin e një ankimi kushtetues nga dy vjet në katër muaj “nga momenti i marrjes dijeni për ndërhyrjen” [në një të drejtë ose liri kushtetuese] (*konstatimi i cenimit*). Ai parashikoi edhe që afati i ri kohor duhet të hyjë në fuqi më 1 mars 2017.

4. Më 19 dhjetor 2017, Gjykata e Lartë rrëzoi rekursin e kërkuesit. Vendimi i Gjykatës së Lartë u miratua me dyer të mbyllura. Kërkuesi paraqiti një kopje të vendimit të Gjykatës së Lartë, që kishte një vulë e cila tregonte se ishte “marrë” nga kërkuesi më 9 maj 2018.

5. Më 6 shtator 2018, kërkuesi depozitoi një ankim kushtetues. Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin më 14 janar 2020, sepse ishte depozituar jashtë afatit kohor katërmujor, duke filluar nga data e miratimit të vendimit të kontestuar të Gjykatës së Lartë. Gjykata Kushtetuese u shpreh që vula në vendimin e Gjykatës së Lartë që tregonte se kërkuesi e kishte “marrë” në atë datë nuk mund të konsiderohej si provë që ai vendim i ishte njoftuar kërkuesit po në atë datë sepse sa herë që një palë

kërkonte të merrte vendimin e Gjykatës së Lartë në atë vendim vendosej vula me datën e dhënies së vendimit.

VLERËSIMI I GJYKATËS

SHKELJA E PRETENDUAR E PARAGRAFIT 1 TË NENIT 6 TË KONVENTËS

6. Gjykata vëren se kjo kërkesë nuk është haptazi e pabazuar sipas kuptimit të nenit 35§3 (a) të Konventës ose e papranueshme bazuar në ndonjë shkak tjetër. Prandaj, ai duhet të shpallet i pranueshëm.

7. Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë në lidhje me afatin e ri katërmujor të prezantuar rishtazi për depozitimin e një ankimi kushtetues janë përmbledhur në *Supergrav Albania sh.p.k. kundër Shqipërisë* (nr. 20702/18, §§16 dhe 22, 9 maj 2023). Në atë çështje Gjykata gjeti shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës ku afati kohor për depozitimin e një ankimi kushtetues ishte llogaritur nga data e miratimit të vendimit të kontestuar të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data që i ishte dhënë kërkuesit (ibid., §§17–31).

8. Në këtë çështje kërkuesi mësoi për vendimin e Gjykatës së Lartë më 9 maj 2018 dhe depozitoi ankimin e tij kushtetues më 6 shtator 2018, brenda afatit kohor katërmujor.

9. Gjithashtu Gjykata vëren që Gjykata Kushtetuese ishte shprehur që sa herë që një palë kërkonte të merrte vendimin e Gjykatës së Lartë, në atë vendim vendosej data e dhënies së vendimit. Sipas Gjykatës Kushtetuese kjo nuk provonte që palës nuk i ishte dhënë vendimi më herët. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nuk sqaroi në çfarë mënyre një palë mund të jepte një provë pozitive të datës së njoftimit të parë (krahasoni *Aždajić kundër Sllovenisë*, nr. 71872/12, §69, 8 tetor 2015) ose arsyen pse barrën e provës në këtë drejtim duhej ta kishte vetëm njëra palë. Gjykata vlerëson se fillimisht i takon Gjykatës së Lartë të sigurohet që në dosjen e saj të çështjes të ketë prova për datën e dhënies së vendimit të saj te palët (shihni *mutatis mutandis*, *Zela kundër Shqipërisë*, nr. 33164/11, §38, 11 qershor 2024).

10. Nisur nga rrethanat më sipër, Gjykata del në përfundimin që gjen shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës në lidhje me të drejtën e kërkuesit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

11. Kërkuesi kërkoi 5600 euro (EUR) për dëmin pasuror dhe jopasuror, dhe 5300 euro (EUR) për kosto dhe shpenzime të kryera pranë Gjykatës.

12. Qeveria i kundërshtoi këto pretendime.

13. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje shkakësore ndërmjet shkeljes së gjetur dhe dëmit pasuror të pretenduar; prandaj e refuzon këtë kërkesë. Megjithatë, i cakton kërkuesit 3600 EUR për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuesit.

14. Duke pasur parasysh dokumentet përpara saj, Gjykata e vlerëson të arsyeshme që t'i caktojë 2000 EUR për kosto dhe shpenzime për proceset përpara Gjykatës, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. *Shpall* kërkesën të pranueshme;
2. *Shprehet* që konstaton shkelje të nenit 6§1 të Konventës;
3. *Vendos*:

a) që Shteti i paditur t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve, shumat e mëposhtme, që do të konvertohen në monedhën e shtetit të paditur me kursin e këmbimit në fuqi në datën e shlyerjes:

- i. 3600 (tre mijë e gjashtë qind euro) për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet;
- ii. 2000 euro (dy mijë euro) për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuesit;

b) nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, interes i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tri pikë përqindje;

4. *Rrëzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuarit për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 15 korrik 2025 sipas Rregullit 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
Zëvendëskancelar në detyrë

Úna Ní Raifeartaigh
President